

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVES, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku-kryetar, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.P., nga Mitrovica , rruga” ...” nr.48, për shkak të veprave penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 297 par 5 lidhur me par 3 dhe 1 të KPK-ës dhe Mosdhënja e ndihmës personit të lënduar në fatkeqsin e trafikut publik, nga neni 301 par 3 lidhur me par 1 të KPK-ës, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit S.P., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë , P.nr.962/2006, datë 30.11.2007, në seancën e kolegjit të mbajtur me 30.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me rastin e ankesës së të akuzuarit S.P., e sipas detyrës zyrtare, detyrimisht ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë , P.nr.962/2006, datë 30.11.2007, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, ndaj të akuzuarit S.P., për shkak të veprave penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 297 par 5 lidhur me par 3 dhe 1 të KPK-ës dhe Mosdhënja e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik, nga neni 301 par 3 lidhur me par 1 të KPK-ës, refuzohet akuza në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par 1.3 të KPP lidhur me nenin 91 par 6 të KPK, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike të palës së dëmtuar aktgjykimi i lartcekur mbetet i paprekur.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë , P.nr.962/2006, datë 30.11.200, i akuzuari S.P. , është shpallur fajtor për shkak të veprës penale veprave penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 297 par 5 lidhur me par 3 dhe 1 të KPK-ës dhe Mosdhënja e ndihmës personit të lënduar në fatkeqsin e trafikut publik, nga neni 301 par 3 lidhur me par 1 të KPK-ës, dhe është gjykuar , ashtu që për veprën penale nën piken I të dispozitivit të akuzës është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatjeje prej 2 muajsh, ndërsa për veprën penale nën piken II të dispozitivit të akuzës është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 muaji dhe të njëjtit gjykata i shqiptoi dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 3 muajsh, dënim ky të cilin gjykata të akuzuarit i'a zëvendëson me dënim me gjobë, ashtu që i akuzuari është obliguar ta paguaj në emër të një dite burgu shumën prej 15 (pesëmbëdhjetë) euro, dhe në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30 euro si dhe shpenzimet për ekspertizën e komunikacionit prej 40,88 euro e në shumë të përgjithshme prej 70,88 €, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari B.T. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është

udhëzuar që këtë kërkesë ta realizojë nga bashkësia e sigurimit ku i akuzuari e ka të siguruar automjetin.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur i akuzuari S.P. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plot të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit të sanksionit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim ose aktgjykimi të ndryshohet ashtu që të i shqiptohet dënim i kushtzuar.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/II.nr.623/2017, të datës 26.05.2017, propozon që sipas detyrës zyrtare të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor të refuzohet aktakuza, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtojë të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, vlerësoi aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 të KPPK, gjeti se:

- me rastin e ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht duhet të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, dhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KP, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Nga aktgjykimi i kundërshtuar del se i akuzuari S.P., është shpallur fajtor dhe gjykuar për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 297 par 5 lidhur me par 3 dhe 1 të KPK-ës dhe veprës penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqsin e trafikut publik, nga neni 301 par 3 lidhur me par 1 të KPK-ës, për të cilat vepra penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 297 par 5 lidhur me par 3 dhe 1 të KPK-ës, parshifet dënim prej 6 muajve deri në 5 vjet, ndërsa për veprën penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqsin e trafikut publik, nga neni 301 par 3 lidhur me par 1 të KPK-ës, parshifet dënim me burgim deri në 1 vit, kurse veprat penale rezultojn se janë kryer me datë 07.07.2006. Sipas dispozitës së nenit 90 par. 1 pika 4 të KPK, i cili ishte i zbatueshëm në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale, për veprat penale të dënueshme mbi 3 vjet burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 5 (pesë) vjet nga kryerja e veprës penale, ndërsa sipas dispozitës së nenit 91 par. 6 të KPK, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Duke pasur parasysh, se afati i parashkrimit fillon nga dita kur është kryer vepra penale, rezulton se që nga koha e kryerjes së veprës penale (07.07.2006), e deri në dorzimin e lëndës në këtë Gjykatë dhe mbajtjen e seancës së kolegjit të kësaj Gjykate kanë kaluar më tepër se 10(dhjetë) vite, çka do të thotë se në rastin konkret ndaj të akuzuarit për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor dhe gjykuar ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Meqë, në rastin konkret ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrim, aktgjykimi i kundërshtuar u dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ç'arsye ankesa e të akuzuarit është jolëndore, kurse shpenzimet e procedurës penale konform

nenit 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 403 të KPP, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.602/17, datë 30.05.2017

Bashkëpunor profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Shqipe Qerimi